

V E N D I M
Nr.424, datë 5.9.1994

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.152, DATË
5.4.1994 “PËR KUSHTET E PËRFITIMIT, SHUMËN DHE PROCEDURËN E DHËNIES SË
PENSIONEVE TË POSAÇME SHTETËRORE DHE TË SHITESAVE TË PENSIONEVE**

Me propozimin e Ministrisë së Punës, Emigracionit dhe Përkrahjes Sociale, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.152, datë 5.4.1994, pika 5 ndryshohet si vijon:

“Pensioni i posaçëm shtetëror nuk mund të jetë më i ulët se pensioni bazë dhe as më i lartë se dyfishi i pensionit maksimal.

Kufiri maksimal i shtesës së pensionit do të jetë deri në pensionin maksimal, por shuma e pensionit që i takon sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë të mos kalojë dyfishin e pensionit maksimal”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi